



## VLERËSIMI I

QEVERISJES SË MIRË NË NJËSITË E  
VETËQEVERISJES LOKALE NË  
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT  
PËRMES INDEKSIT TË HAPJES

MATJA PËR VITIN 2021



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN



# **VLERËSIMI I QEVERISJES SË MIRË**

NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT  
PËRMES INDEKSIT TË HAPJES – MATJA  
PËR VITIN 2021

Botues:

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis

Redaktore:

Bardhyl Jashari

Përkthyes:

Marta Ziba (përkthim nga gjuha maqedonase në shqip)



Ky botim u përgatit nga Fondacioni Metamorfozis si pjesë e Projektit për Pjesëmarrje Qytetare me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## **PËRMBAJTJA**

<b>1.Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>2. Metodologjia</b>	<b>5</b>
<b>3.Hapja e institucioneve të vetëqeverisjes lokale në republikën e maqedonisë së veriut</b>	<b>8</b>
3.1. Gjendja e qeverisjes së mirë në institucionet e vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut	8
3.2. Transparenca	14
3.2.1. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie	16
3.2.2. Informacione organizative	18
3.2.3. Vendimmarrja	19
3.2.4. Transparenca financiare	21
3.3. Vetëdijësimi	23
3.3.1. Planifikimi dhe programimi	24
3.3.2. Monitorimi dhe vlerësimi	25
3.4. Qasshmëria	27
3.4.1. Qasja në informacione dhe shërbime	28
3.4.2. Konsultime publike	30
3.4.3. Ndërveprimi me qytetarët	32
3.5. Integriteti	33
3.6. Të dhënat e hapura	35
3.7. Këshillat komunalë dhe ndërmarrjet publike	37
<b>4.Përfundim</b>	<b>38</b>
<b>5. Plani gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut</b>	<b>39</b>
Shtojca 1: Struktura e Indeksit të hapjes në nivel lokal	44

# 1. HYRJE

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, me mbështetje të Projektit të USAID-it për Pjesëmarrje Qytetare bëri vlerësim të gjendjes së qeverisjes së mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

Indeksi i hapjes është një metodologji për vlerësimin e punës së NJVL-ve që bazohet në Indeksin tashmë të përpunuar për matjen e hapjes të njësive të vetëqeverisjes lokale në rajonin e gjashtë vendeve të cilat nuk janë anëtare të BE-së në Evropën Juglindore (EJL6). Indeksi i merr parasysh dallimet dhe specifikat e secilit vend, si nga aspekti i detyrimeve ligjore të NJVL-ve, ashtu edhe nga aspekti i praktikave. Metodologjia u revidua në fillim të vitit 2021 me qëllim që të bëjë përshtatjen e komponentave të indeksit (fushat, nën-fushat, treguesit, mjetet) që të mundësojë një zbatueshmëri dhe relevancë të plotë për vlerësimin e hapjes së NJVL-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Ky raport ofron një analizë të punës të njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me parimin e transparencës, vetëdijësimin, qasshmërisë dhe intergjitit. Përveç kësaj NJVL-të u monitoruan sipas një fushe të përbashkët të pranishme tek të katër parimet, e që janë të dhënat e hapura. Mbi bazë të vlerësimit të bërë u dhanë rekomandime për përmirësimin e punës të njësive të vetëqeverisjes lokale në fushat e përfshira me hulumtimin.

## 2. METODOLOGJIA

Indeksi i hapjes vlerëson performancën e pushtetit lokal në fushën e qeverisjes së mirë duke u fokusuar në katër parime: (1) transparencë, (2) vetëdijësimi, (3) qasshmëria dhe (4) integriteti dhe në një fushë të përbashkët të pranishme në të katër parimet - të dhënat e hapura.

Indeksi i hapjes paraqet një mjet praktik për matjen e shkallës së përgjithshme të hapjes të NJVL-ve që:

- ▶ jep një pasqyrë të detajuar të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me hapjen e secilës NJVL,
- ▶ mundëson krahasueshmëri mes NJVL-ve me qëllim të nxitjes së mësimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të praktikave më të mira,
- ▶ krijon motivim tek NJVL-të për një përmirësim, përsosje dhe inovacion të vazhdueshëm,
- ▶ është e qasshme dhe e kuptueshme që qytetarët të mund të kenë qasje në hapjen e komunës së tyre, si një nga kriteret themelore për vlerësimin e performancës dhe suksesshmërisë.

Treguesit janë të organizuar në 4 fusha dhe 9 nën-fusha. Katër fushat përputhen me 4 parimet e qeverisjes së hapur: transparencë, vetëdijësimi, qasshmëria dhe integriteti. Përveç kësaj indeksi përmban edhe dy nën-fusha – këshilli komunal dhe ndërmarrjet publike, me çka mundësohet vlerësimi i hapjes së komunës kur bëhet fjalë konkretisht për punën e Këshillit apo ndërmarrjeve publike.

Fusha e **transparencës** i referohet politikave, aktiviteteve dhe masave që i ndërmerr komuna për t'i informuar qytetarët e saj në lidhje me punën e saj. Duke pasur parasysh se transparencë është baza për hapjen e komunave, kjo fushë në indeks përmban numër më të madh të treguesve, duke përfshirë këtu transparencën financiare si një nga aspektet më të rëndësishme të punës së komunave.

Fusha e **vetëdijësimit** i referohet cilësisë së planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimin të politikave të zbatuara nga institucionet. Ajo e nënkupton parashikueshmërinë e zbatimit të interesit publik përmes politikave publike në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Kjo fushë e rishikon procesin e krijimit të politikave publike në komunë, përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike, planet për veprim, si dhe zhvillimin e një plani dhe mjeteve për monitorim dhe vlerësim gjatë zbatimit të kompetencave të sektorëve që i ka komuna.

Fusha e **qasshmërisë** i referohet mënyrës në të cilën NJVL-ja komunikon dhe i përfshin qytetarët e komunës në përgjigjen ndaj kërkesave dhe në përbushjen e nevojave të tyre. Qasshmëria lidhet me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informacion, përmirësimin e qasshmërisë në informacion përmes mekanizmave të konsultimit publik dhe përforsimit të ndëveprimit me qytetarët dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve.

Fusha e **integritetit** në kuadër të këtij Indeksi shqyrtohet në funksion të respektimit të vazhdueshëm të vlerave, parimeve dhe normave etike që kanë për qëllim t'i japin përparësi interesit publik mbi atë privat.

**Të dhënat e hapura** janë një aspekt i rëndësishëm i këtij Indeksi dhe shqyrtohen si fushë horizontale. Sipas **Strategjisë për të dhënat e hapura**, të dhënat e hapura njihen si një mundësi për ta përmirësuar qeverisjen në aspektin e transparencës, hapjes dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet, duke i përfshirë ato lokale, dhe gjithashtu mund të jenë një shtysë e fortë për zhvillimin ekonomik dhe social në vend. Në kuadër të Indeksit, për disa nga treguesit bëhet analizë shtesë e mënyrës së publikimit të të dhënave dhe formatit të tyre përmes prizmit të hapjes të të dhënave. Në këtë mënyrë, përmes kësaj qasjeje horizontale, përiqemi ta vlerësojmë angazhimin e komunave për t'i përbushur kërkesat për të dhëna të hapura.

Përpunimi dhe rishikimi i Metodologjisë u bë në bazë të një analize të hollësishme të kornizës kombëtare strategjike dhe ligjore të RMV, dokumenteve ndërkombëtare, iniciativave, standardeve, rekomandimeve dhe praktikave të mira, hulumtimeve për perceptimet dhe pritshmëritë e qytetarëve të RMV-së, si dhe intervistave me faktorët relevantë.

Hulumtimi u realizua nga Fondacioni Metamorfozis, dhe në procesin e realizimit të tij u përfshinë 8 organizata civile lokale: Agtis - Prilep, Qendra për Dialog Ndërkulturor - Kumanovë, Fondacioni për Zhvillimin e Komuniteteve Lokale - Shtip, Qendra për Inovacion Social Blink 42 - 21 - Shkup, Multikultura - Tetovë, Sky Plus - Strumicë, Agjencia Lokale për Zhvillim - Strugë dhe Kuantum Prima - Kavadar.

**Për vitin 2021 me këtë hulumtim u përfshinë të gjitha 80 komunat dhe Qyteti i Shkupit.**

Hulumtimi u realizua nga 1 qershori deri më 15 korrik të vitit 2021. Metodot e hulumtimit u zbatuan përmes (1) kontrollimit të ueb-faqeve të komunave sipas treguesve të përcaktuar dhe (2) pyetësorit të dorëzuar në komuna për të konfirmuar gjetjet e fituara nga monitorimi online. Metodologjia si burim kryesor të informacioneve i përdor ueb-faqet zyrtare të NJVL-ve.

Niveli i dytë i kontrollit për disa nga treguesit përfshiu procesin e përgatitjes dhe zbatimit të një pyetësi si mjet kërkimi. Pyetësi u realizua në mënyrë elektronike dhe përbëhej nga pyetje të paracaktuara dhe opsione përgjigjesh që mundësojnë konfirmim ose përbushje të disa prej rezultateve të fituara nga monitorimi i ueb-faqeve, si dhe



eliminim të çdo lëshimi eventual gjatë monitorimit që do të ishte në dëm të vlerësimit të NJVL-ve për një tregues konkret.

Gabimi në matje është +/- 3%. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit bëmë një analizë me pikat dhe problemet kryesore kritike në fushën e hapjes së komunave, të cilat shpresojmë se do të përdoren për ta përmirësuar punën e tyre.

Nga 80 komunat e monitoruara, përfshirë këtu dhe Qytetin e Shkupit, pyetësorit online i janë përgjigjur vetëm 36 ose 44% prej tyre. Është me rëndësi të theksohet se në rastet kur komunat nuk kanë dorëzuar pyetësorë të plotësuar, për treguesit është dhënë nota 0, pra është vlerësuar sikur ato tregues nuk janë përmbushur. Pra, nga komunat e monitoruara, 36 (44%) iu përgjigjën pyetësorit, ndërsa 45 të tjerat (56%) marrin automatikisht 0 pikë për treguesit përkatës.

Në Shtojcën 1 mund ta shihni strukturën e përgjithshme të Indeksit të hapjes në nivel lokal.

# 3. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

## 3.1. GJENDJA E QEVERISJES SË MIRË NË INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES LOKALE NË MAQEDONINË E VERIUT


Pandemia me KOVID-19 me të cilën u përballëm e theksoi edhe më shumë nevojën për punë të shpejtë dhe efikase të autoriteteve, dhe me këtë edhe të vetëqeverisjes lokale. Në kushte kaq të jashtëzakonshme me kufizime drastike të lirisë së lëvizjes së qytetarëve doli në pah se sa i rëndësishëm është besimi dhe transparencja në punën e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Hulumtimi për vitin 2021 tregoi se numri më i madh i komunave nuk punojnë mjaftueshëm për t'i përmbushur standardet për hapje. Rezultatet në fushat tregojnë se NJVL-të në punën e tyre zbatojnë standarde të ulëta për konsultim, transparencë, monitorim dhe kontroll. Edhe pse në kushte të jashtëzakonshme rënia e efektivitetit dhe efikasitetit të punës në disa fusha është e pashmangshme, ajo gjithsesi duhet të jetë e kufizuar në vëllim dhe kohë që të mund të evitohet krijimi i një perceptimi negativ tek qytetarët për kompetencën, hapjen dhe transparencën e NJVL -së.

Rezultati mesatar i njësive të vetëqeverisjes lokale sipas hulumtimit përmes Indeksit të hapjes për vitin 2021 është 25%. Ky është tregues për një nivel të ulët të hapjes në punën e pushtetit lokal në Republikën së Maqedonisë Veriut.

Notën mesatare më të lartë komunat e kanë për treguesit në fushën e transparencës 32%, ndërsa më të ulët në fushën e vetëdijes 13%.

*Grafiku 1. Hapja e NJVL-ve për vitin 2021 sipas parimeve të Indeksit të hapjes*




Rezultati shumë i ulët në fushën e vetëdijes flet për cilësinë e dobët të planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave që zbatohen nga NJVL-të. Kjo ka një rëndësi të veçantë sepse zbatimi i interesit publik duhet të bëhet fillimisht përmes politikave publike në njësinë e vetëqeverisjes lokale.

Sipas Ligjit për Organizimin Territorial të Vetëqeverisjes Lokale, vetëqeverisja lokale nga aspekti territorial është e organizuar në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit, si një njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Sipas Kushtetutës tonë, njësitë e vetëqeverisjes lokale, pra komunat, janë të barabarta në të drejtat dhe obligimet e tyre, pa dallim nga karakteri i tyre urban ose rural, niveli i zhvillimit, madhësia hapësinore dhe demografike dhe dallimet dhe specifikat e tjera. Prandaj, në hulumtim të gjitha komunat trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga madhësia, numri i punonjësve dhe të ngjashme.


Parimet e hapjes të përfshira në Indeksin e hapjes janë të mbuluara në një numër ligjesh, aktesh nënligjore dhe udhëzuesëve që synojnë të përmirësojnë hapjen e institucioneve të qeverisjes lokale dhe ta përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Indeksi i hapjes tregoi se në matjet për vitin 2021 rezultate më të mira kanë Komuna e Ohrit (51%), Vasilevës (48%) dhe Koçanit (48%), ndërsa më të dobëta Komuna e Pllasnicës (3%).

*Grafiku 2. 10 NJVL-të më të mira sipas Indeksit të hapjes për vitin 2021*




*Grafiku 3. NJVL-të me rezultatet më të dobëta sipas Indeksit të hapjes për vitin 2021*



Sa i përket rajoneve planifikuese, hulumtimi tregoi se më të hapura janë komunat në Rajonin Juglindor, me një hapje mesatare prej 34%, ndërsa më pak të hapura janë komunat në Rajonin e Pollogut me një hapje mesatare prej 19%.

Grafiku 4. Shkalla e hapjes së rajoneve planifikuese për vitin 2021



Radhitja e komunave nga aspekti i matjes së Indeksit të hapjes për vitin 2021 është si vijon:

Rangu	Komuna	Përqindja e përgjithshme e hapjes
1	Ohër	51%
2	Vasilevë	48%
2	Koçan	48%
3	Manastir	46%
3	Kavadar	46%
3	Vallandovë	46%
4	Veles	45%
5	Karposh	41%
5	Prilep	41%
6	Gjevgjeli	40%
7	Shtip	39%
7	Zhelinë	39%
8	Kriva Pallankë	37%
8	Kumanovë	37%
8	Demir Hisar	37%
9	Strumicë	36%

Rangu	Komuna	Përqindja e përgjithshme e hapjes
9	Vevçan	36%
9	Berovë	36%
9	Dellçevë	36%
10	Radovish	35%
10	Gjorçe Petrov	35%
10	Qendër	35%
10	Konçe	35%
10	Makedonska Kamenicë	35%
11	Bogdanci	32%
11	Qyteti i Shkupit	32%
11	Aerodrom	32%
11	Gazi Babë	32%
12	Krushevë	31%
12	Sveti Nikole	31%
13	Gostivar	30%
13	Kratovë	30%
13	Negotinë	30%
14	Ilinden	29%
14	Çashkë	29%
15	Novo Sellë	28%
15	Kisella Vodë	28%
16	Petrovec	26%
16	Tetovë	26%
17	Likovë	25%
17	Dibër	25%
18	Zërnovci	24%
18	Novaci	24%
18	Debërcë	24%
19	Prespë	23%
19	Gradsko	23%
20	Kërçovë	21%
21	Bosilovë	20%
21	Shuto Orizare	20%
21	Çeshinovë-Obleshevë	20%
21	Strugë	20%

Rangu	Komuna	Përqindja e përgjithshme e hapjes
22	Makedonski Brod	19%
22	Bërvenicë	19%
22	Çair	19%
23	Mogillë	18%
23	Rosoman	18%
24	Dojran	17%
24	Jegunovce	17%
24	Pehçevë	17%
24	Vinicë	17%
24	Qendra Zhupa	17%
24	Krivogashtani	17%
25	Dollnen	16%
26	Mavrovë dhe Rostushe	15%
27	Rankovce	14%
27	Bogovinjë	14%
27	Demir Kapija	14%
27	Llozovë	14%
28	Probishtip	13%
28	Karbinci	13%
29	Saraj	11%
30	Butel	10%
31	Tearcë	8%
32	Zelenikovë	7%
32	Studeničan	7%
32	Sopishte	7%
32	Nagoriçan i vjetër	7%
33	Haraçinë	5%
33	Çuçer-Sandevë	5%
33	Vrapçisht	5%
34	Pllasnicë	3%

Në vazhdim të dokumentit është dhënë një pasqyrë e rezultateve të NJVL-ve në secilën fushë dhe nën-fushë.

## 3.2. TRANSPARENCA

*„Transparenca“ i referohet politikave, aktiviteteve dhe masave që i ndërmer komuna për t'i informuar qytetarët e saj në lidhje me punën e saj*

Transparenca dhe llogaridhënia duhet të jenë parimet nismëtare në punën e komunave. Edhe pse në mënyrë deklarative të gjitha NJVL-të angazhohen për një transparencë më të madhe, në fakt shumë pak prej tyre i publikojnë të gjitha informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me punën e tyre.

Ekzistenca e mjeteve bazë për informimin e qytetarëve është obligim ligjor i komunave. Qasshmëria dhe funksionaliteti i mjeteve të informacionit është një angazhim i komunës për tua prezantuar informacionet qytetarëve të saj në mënyrën më të përshtatshme.


Publikimi dhe qasja në informacione në lidhje me punën e komunave, buxhetet, publikimet e kontratave, vendimeve për punësim ose prokurimeve publike përmes internetit e përforcon kontrollin dhe mbikëqyrjen e jashtme nga organizatat civile, ekspertët dhe publiku në përgjithësi.

Niveli më i lartë i transparencës së NJVL-ve gjithashtu është edhe një mjet i rëndësishëm në luftën kundër dezinformatave dhe lajmeve të rreme.

Hulumtimi për vitin 2021 tregoi se të gjitha komunat kanë ueb-faqe funksionale, por një pjesë e konsiderueshme e tyre janë realizuar në një nivel shumë të ulët, disa nuk janë në domenin gov.mk, dhe disa nuk i përmbushin kërkesat për siguri kibernetike.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin 32% të treguesve që bëjnë pjesë në fushën e transparencës.


*Grafiku 5. Transparenca e NJVL-ve sipas katër nën-fushave*





Ky rezultat tregon se transparenca e NJVL-ve duhet të përmirësohet dukshëm. Pushteti lokal në mënyrë proaktive duhet të publikojë sa më shumë informacion që të jetë e mundur në ueb-faqet e komunave sepse tani ato janë burimi kryesor i informacionit për cilësinë e qeverisjes. Komunitat duhet të bëjnë përpjekje për ta rritur transparençën e përgjithshme në punën e tyre dhe në veçanti publikimin e të dhënave në lidhje me vendimet e marra nga Kryetari i komunës dhe Këshilli, si dhe të dhënave në lidhje me punën financiare.

Grafiku 6.10 komunat me rezultate më të mira në fushën e transparençës



Sa i përket transparençës rezultate më të mira ka treguar Komuna e Vasilevës (58%), ndërsa më të dobëta Komuna e Vrapçishtit (4%).

Gjatë hulumtimit u vu re se një numër të madh të informacioneve, dokumenteve dhe të të dhënave të rëndësishme NJVL-të i publikojnë vetëm në gazetatat zyrtare. Kjo është një praktikë negative sepse gjetja dhe përpunimi i të dhënave të publikuara në këtë mënyrë është shumë e vështirë. Është e qartë se qytetari i zakonshëm në shumicën e rasteve nuk do të jetë në gjendje të arrijë deri tek informacioni i dëshiruar që është publikuar në gazetatat zyrtare, me çka nuk përmbushet qëllimi themelor i tyre – informimi i qytetarëve. Këto të dhëna dhe informacione duhet të jenë të strukturuar mirë dhe të publikohen drejtpërdrejt në kuadër të menysë dhe rubrikave të uebfaqes së komunës që qasja në to të jetë e lehtë.

Në fushën e transparencës treguesit janë të organizuar në katër nën-fusha:

- ▶ Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie, që i përfshin politikat për transparencë dhe llogaridhënie dhe trajnimin e vazhdueshëm në këtë temë;
- ▶ Informacione organizative në lidhje me strukturën e komunës, kompetencat themelore dhe çështjet kadrovike në komunë;
- ▶ Marrja e vendimeve nga ana e Këshillit dhe Kryetarit të komunës;
- ▶ Transparenca financiare, që i përfshin prokurimet publike, buxhetin, llogaritë përfundimtare dhe raportet financiare.

### 3.2.1. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie

Ekzistenca e një politike të qartë për transparencën, llogaridhënien dhe qasshmërinë në komunë flet për përkushtimin e komunës për të qenë në shërbim të qytetarëve. Komunitat i përmbushin disa nga kërkesat ligjore për publikimin e informacionit dhe të dokumenteve. Por, këto informacione shpesh publikohen në formate që nuk janë të përshtatshme për kërkim dhe përpunim. Prezantimi i të dhënave të hapura nga komunitat do të mundësojë përpunim më të lehtë të të dhënave dhe transparencë më të madhe të komunës. Të dhënat e hapura janë një nga angazhimet më të rëndësishme në Programin për Partneritet të Hapur të Qeverisë së RMV-së. Angazhimi afatgjatë për hapjen e komunës duhet të shkrihet në një plan të veçantë strategjik ose veprimi që duhet të publikohet në uebfaqen e komunës.

Kjo nën-fushë përmban tregues për politikën themelore të komunës për transparencën dhe llogaridhënien, si: ekzistenca e një përcaktimi strategjik të komunës për të qenë transparente dhe llogaridhënese; investimi në edukimin e nëpunësve të komunës për transparencë dhe llogaridhënie; ekzistimi i parakushteve themelore për informimin e qytetarëve dhe prezantimin e të dhënave të komunës në format të hapur.

**Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin 31% të treguesve të përfshirë në nën-fushën e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie.**

Ueb-faqet e komunave janë vendi kryesor ku qytetarët qasen për të marrë të dhëna dhe informacione për punën e komunave, ose për të ushtruar ndonjë nga të drejtat ose obligimet e tyre. Prandaj, ueb-faqet e komunave janë mjeti më i rëndësishëm për informim dhe NJVL-të duhet të sigurojnë që ky mjet të jetë funksional dhe i dobishëm për qytetarët.


**Hulumtimi për vitin 2021 tregoi se një pjesë e NJVL-ve duhet ta përmirësojnë cilësinë e ueb-faqeve të tyre dhe t'i bëjnë ato më të përshtatshme për përdoruesit.** Një pjesë e madhe e uebfaqeve të komunave ende nuk i përmbajnë informacionet themelore që kërkohen me ligj; një pjesë e tyre, si Komuna e Krivogashtanit, nuk janë regjistruar në domenin gov.mk; disa komuna, si Komuna e Ilindenit, kanë nga dy ueb-faqe; një pjesë e ueb-faqeve, si ajo e Komunës së Sarajit, nuk i përmbushin kërkesat për siguri kibernetike dhe një numër i madh nuk kanë mjete funksionale për kërkim.

Një pjesë e komunave nuk i përditësojnë rregullisht të gjitha verzionet gjuhësore të ueb-faqeve, pra informacionet nuk publikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk janë të disponueshme në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.

Shumica e komunave nuk kanë ndonjë dokument (strategji, politikë, procedurë) në lidhje me hapjen dhe transparencën. Komunitat gjithashtu duhet të investojnë më shumë në edukimin e nëpunësve për tema të tilla si transparenca, llogaridhënia, të dhënat e hapura dhe të ngjashme.

Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie, rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Verilindor (41%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin e Vardarit (24%).

*Grafiku 7. Shkalla e hapjes së rajoneve planifikuese në nën-fushën e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie për vitin 2021*



Në nën-fushën e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie, sipas hulumtimit rezultate më të mira kanë treguar Komuna e Strumicës dhe Likovës me 78%, ndërsa më të dobëta Komuna e Mogillës, Vrapçishtit dhe Pllanicës me 9%.

Në përgjithësi, mund të konkludohet sa i përket funksionalitetit dhe dobisë së tyre ueb-faqet e komunave janë të kufizuara. Shumica e ueb-faqeve nuk janë të lehta për t'u përdorur dhe vizitorët shpesh nuk mund t'i marrin lehtë dhe shpejt të dhënat e nevojshme. Komunitat duhet të përgatisin një dokument që dokumenton përcaktimin e tyre strategjik për të qenë transparente dhe të përgjegjshme.

### 3.2.2. Informacione organizative

Qasja në informacione themelore për kompetencat e komunës, dokumentet themelore për punën e komunës dhe çështjet kadrovike janë obligim ligjor i komunave. Përmes këtyre të dhënave qytetarët i marrin informacionet themelore për funksionimin e komunës, kontaktet themelore të vendimmarrësve dhe personave që janë të angazhuar për zbatimin e tyre. Në fakt, me këto të dhëna jepet një pasqyrë themelore për punën e komunës, fushat e saj të veprimit dhe matet qasshmëria dhe ndihmesa që nëpunësit e komunës ua japin qytetarëve.

Sipas kornizës ligjore në vendin tonë, NJVL-të kanë përgjegjësi për mbledhjen e një numri të madh të të dhënave dhe mbajtjen e evidencës. Nëse këto të dhëna nuk janë të kufizuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ato duhet të publikohen në ueb-faqet e komunave.


Kjo nën-fushë përmban tregues që kanë të bëjnë me: të dhënat themelore për kompetencat e komunës dhe pronën e saj; dokumentet themelore për punën e komunës; informacionet themelore për organet e ndryshme komunale: Kryetarin e komunës, Këshillin, ndërmarrjet publike, bashkësitë lokale, çështjet kadrovike dhe strukturën organizative.

**Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin 45% të treguesve të përfshirë në nën-fushën e informacioneve organizative.**

Në përgjithësi në ueb-faqe komunat publikojnë informacione të kufizuara sa i përket punës së tyre. Në të shumtën e rasteve NJVL-të publikojnë dokumente themelore për punën e komunës si Statuti, Procesverbal, organogrami, të dhënat në lidhje me anëtarët e Këshillit, etj. Një numër shumë i vogël i komunave në ueb-faqet e tyre publikojnë informacion të detajuar për ndërmarrjet publike dhe punën e tyre.

**Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e informacioneve organizative rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Verilindor (51%), ndërsa më të dobëta ato në Rajonin e Shkupit (39%).**

Grafiku 8. Shkalla e hapjes së rajoneve planifikuese në nën-fushën e informacioneve organizative



Në nën-fushën e informacioneve organizative, sipas hulumtimit rezultate më të mira ka Komuna e Zhelinës (76%), ndërsa më të dobëta Komuna e Pllasnicës me 0%.

Mund të konkludohet se komunat duhet të publikojnë në ueb-faqet e tyre të dhëna për çështjet kadrovike, siç janë listat e plota të punonjësve me të dhënat për kontakt, të dhënat për personat e angazhuar me kontrata në vepër, kontrata për punë të përkohshme dhe kontrata autoriale. Gjithashtu duhet të përfshijnë më shumë informacione të detajuara në lidhje me ndërmarrjet publike dhe punën e tyre, e jo vetëm një përshkrim të shkurtër ose një link.

### 3.2.3. Vendimmarrja

Qytetarët shpesh drejtohen në komunë dhe perceptimi i tyre për këtë institucion shpesh kufizohet tek Kryetari i saj. Roli i Këshillit si vendimmarrës dhe politikëbërës në të shumtën e rasteve anashkalohet.

Kjo nën-fushë përmban tregues që kanë të bëjnë me qasshmërinë në të dhëna lidhur me procesin e vendimmarrjes, ose transparencën e seancave të Këshillit, disponueshmërinë e dokumenteve dhe vendimeve të marra, komunikimin me mediat dhe qytetarët, si nga Këshilli ashtu edhe nga Kryetari i komunës.


Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin vetëm 25% të treguesve të përfshirë në nën-fushën e vendimmarrjes. Ky paraqet rezultatin më të ulët në raport me katër nën-fushat në fushën e transparencës.

Hulumtimi nxorri në pah se komunat publikojnë shumë pak të dhëna që kanë të bëjnë me procesin e marrjes së vendimeve nga ana e Këshillit dhe Kryetarit të komunës. Fakti që 21 komuna nuk kanë publikuar kurrëfarë të dhënash në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve është shqetësues.

Kjo është një fushë e rëndësishme që duhet të përmirësohet, sepse me një qasje më të madhe në informacione për vendimet e Këshillit dhe Kryetarit të komunës, me një raportim në kohë për punën e tyre, qytetarët kanë mundësi për tu kyçur në miratimin e politikave publike në nivel lokal.

Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e vendimmarrjes rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Juglindor (52%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin e Pollogut (15%).

*Grafiku 9. Shkalla e hapjes së rajoneve planifikuese në nën-fushën e vendimmarrjes*



Në këtë nën-fushë, hulumtimi tregoi se rezultate më të mira ka Komuna e Strumicës (76%), ndërsa 21 komuna të tjera (Çairi, Tearca, Sopsishteja, Çuçer-Sandeva, Dollneni, Demir Kapija, Probishtipi, Ilinden, Makedonski Brodi, Haraçina, Pllasnica, Likova, Vrapçishti, Rankovca, Kërçova, Saraji, Qendra e Zhupës, Nagoriçani i Vjetër, Buteli, Studeniçani dhe Krivogashtani) nuk kanë publikuar kurrëfarë informacioni në lidhje me procesin e vendimmarrjes.

Fakti që një e katërta e komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk kanë publikuar kurrëfarë të dhënash për vendimet të cilat merren nga ana e Kryetarit të komunës-dhe nga Këshilli, ndërkohë që komunat e tjera kryesisht publikojnë të dhëna të

pjesëshme, paraqet një mangësi serioze që duhet të adresohet nga ana e NJVL-ve. Këto të dhëna janë një nga të dhënat më të rëndësishme të cilat komunat duhet t'i publikojnë rregullisht dhe në kohë, sepse ato në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në cilësinë e jetesës në bashkësitë lokale dhe mundësojnë ndjekjen e punës së Kryetarit të komunës dhe Këshillit nga qytetarët dhe palët e interesuara.

### 3.2.4. Transparenca financiare

Qasja në dhe transparenca e të gjithë informacioneve financiare: buxhetet, llogaritë përfundimtare, raportet financiare dhe prokurimet publike janë një detyrim ligjor i komunave dhe ndërmarrjeve publike. Planifikimi dhe shpenzimi i parave publike në mënyrë transparente është një angazhim i një pjese të komunave dhe vihen re praktika të mira të publikimit të informacioneve në një format të përshtatshëm dhe të kuptueshëm për qytetarët dhe përfshirje e qytetarëve në përcaktimin e prioriteteve gjatë planifikimit financiar.


**Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin vetëm 27% të treguesve të përfshirë në nën-fushën e transparencës financiare.**

Komunat duhet të publikojnë më shumë të dhëna dhe informacione sa i përket buxhetit dhe shpenzimit të parave publike sepse kjo kontribuon në zvogëlimin e korrupsionit, si dhe në sigurimin e pjesëmarrjes efektive të qytetarëve në procesin e buxhetimit.

Në hulumtim u vu re se 12 komuna nuk e kanë publikuar buxhetin e komunës në ueb-faqen e tyre. Pjesa më e madhe e NJVL-ve duhet të përmirësojnë procesin e buxhetimit participativ në mënyrë që në procesin e buxhetimit dhe planifikimit financiar të përfshihen edhe qytetarët. Në këtë mënyrë qytetarët mund të përfshihen në pjesën më të rëndësishme të hartimit të politikave në nivel lokal. Vetëm 10 komuna i kanë publikuar buxhetet për qytetarët, që i pamundëson ato që në një mënyrë të thjeshtë, përmes grafikëve dhe ilustrimeve, ta kuptojnë buxhetin. Komunat nuk publikojnë të dhëna për rrogat e zyrtarëve dhe shpërblimet për anëtarët e Këshillit të komunës.

**Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e transparencës financiare rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin juglindor (38%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin e Pollogut (15%).**

Grafiku 10. Shkalla e hapjes së rajoneve planifikuese në nën-fushën e transparencës financiare



Në nën-fushën e transparencës financiare, hulumtimi tregoi se rezultate më të mira ka komuna e Karposhit (58%), ndërsa më të dobëta komuna e Tearcës, Sarajit, Studeniçanit, Sopihtes, Probishtipit, Vrapçishtit dhe Haraçinës, të cilat nuk publikojnë kurrfarë të dhënash për punën financiare të tyre.

Mund të konkludohet se komunat duhet të publikojnë më shumë informacione financiare, siç janë raportet financiare tremujore dhe vjetore, informacione ose linqe për punën financiare të ndërmarrjeve publike, fondet e ndara për organizatat e shoqërisë civile, të dhëna për rrogat e zyrtarëve dhe shpërblimet për anëtarët e Këshillit të komunës. Një pjesë e komunave duhet të promovojnë llogaridhënien në publikimin e informacioneve në lidhje me prokurimet publike, gjegjësisht t'i publikojnë planet për prokurimet publike, shpalljet, vendimet, kontratat dhe anekset.



### 3.3. VETËDIJËSIMI


*„Vetëdijësimi“ i referohet cilësisë së planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave të cilat zbatohen nga institucionet*

Parashikueshmëria e zbatimit të interesit publik përmes politikave publike ka një rëndësi qenësore për qytetarët. Për të arritur parashikueshmëri gjatë marrjes së vendimeve në nivel lokal, është e nevojshme që paraprakisht të planifikohen qëllimet që NJVL-ja dëshiron t'i arrijë dhe ato të vendosen në një dokument strategjik publik dhe të qasshëm për qytetarët. Bazuar në këto qëllime bëhet vlerësimi i politikave publike duke përdorur mjete për monitorim dhe vlerësim për ta vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e politikave publike në arritjen e qëllimeve të përcaktuara.


Kjo fushë e shqyrton procesin e krijimit të politikave publike në komunë, përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike, planet e veprimit, si dhe zhvillimin e planit dhe mjeteve për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kompetencave sektoriale që i ka komuna.

Hulumtimi tregoi se NJVL-të kanë një notë mesatare prej 13% për treguesit e fushës së vetëdijësimi. Kjo është fusha ku komunat kanë treguar rezultate më të dobëta. 32 NJVL ose 40% e komunave nuk publikojnë kurrfarë dokumente ose të dhëna në këtë fushë. NJVL-të punojnë shumë pak për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave për efektivitetin e politikave, shkallën e zbatimit dhe ndikimin e tyre. Prandaj, është e nevojshme që komunat të zbatojnë mekanizma sistematikë që do bëjnë vlerësim të rregullt të ndikimit, shpenzimeve dhe efekteve të politikave dhe që do të shërbejnë për zhvillimin e planeve strategjike për të ardhmen, duke u mbështetur si dëshmi tek të dhënat.

*Grafiku 11. Vetëdijësimi i NJVL-ve në Maqedoninë e Veriut sipas dy nën-fushave*



Grafiku 12.10 komunitet me rezultate më të mira në fushën e vetëdijësimit



Në fushën e vetëdijësimit rezultate më të mira ka komuna e Dellçevës me 60%, ndërsa 32 NJVL të tjera janë vlerësuar me 0% sepse nuk publikojnë kurrëfarë dokumente dhe të dhëna nga kjo fushë: Tearca, Tetova, Bosillova, Krivogashtani, Dojrani, Demir Kapija, Petroveci, Strumica, Mogilla, Llozova, Makedonski Brodi, Dibra, Pllasnica, Vinica, Bogovinja, Karbinci, Vrapçishti, Pehçeva, Sopishteja, Probishtipi, Zelenikova, Haraçina, Struga, Rankovci, Jegunovca, Saraji, Gazi Baba, Nagoriçani i Vjetër, Çuçer-Sandeva, Studeniçani, Bërvenica dhe Buteli.

Në kuadër të fushës së vetëdijësimit bëjnë pjesë këto nën-fusha:

- ▶ Planifikimi dhe programimi, pra përpilimi i programeve për punën e komunës, dokumenteve strategjike për zhvillim dhe zhvillimi i treguesve për monitorim;
- ▶ Monitorimi dhe vlerësimi (realizimi i planeve vjetore, raportimi, përdorimi i treguesve për matjen e suksesshmërisë së zbatimit të politikave)


### 3.3.1. Planifikimi dhe programimi

Dokumentet strategjike për zhvillim dhe programet për punën e Kryetarit dhe Këshillit të komunës janë dokumente të rëndësishme në nivel lokal që tregojnë për një qasje të planifikuar për ndërtimin e politikave publike lokale në shërbim të nevojave të qytetarëve. Qasja e qytetarëve në këto dokumente është një hap drejt përfshirjes më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje, ndërsa ekzistenca e treguesve adekuatë për monitorimin dhe vlerësimin e dokumenteve flet për nivelin e cilësisë së dokumenteve. Planifikimi strategjik duhet të jetë i lidhur ngushtë me procesin e përgatitjes së buxhetit të komunave. Praktika e planifikimit të buxhetit pa një kornizë strategjike adekuate bën që komunitet të mos bëjnë planifikim real të buxheteve e që si pasojë ka borxhe të mëdha.

Nevojitet përmirësim i dukshëm i procesit të planifikimit strategjik në nivel lokal. Numri më i madh i komunave nuk i publikojnë dokumentet e nevojshme strategjike dhe planifikuese dhe nuk kanë një plan të shkruar që i përcakton qëllimet për zhvillim (Strategjia për zhvillimit) dhe/ose një plan veprimi për zbatimin e Strategjisë për zhvillim.

Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e planifikimit dhe programimit rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin e Vardarit (26%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin e Pollogut (2%).

Grafiku 13. Përbushja e treguesve në nën-fushën e planifikimit dhe programimit në rajonet planifikuese



Rezultatet për këtë nën-fushë, si dhe për fushën, tregojnë rezultate të dobëta. 37 komuna nuk i përmbushin aspak treguesit e përfshirë në nën-fushën e planifikimit dhe programimit. Një shembull pozitiv në këtë nën-fushë është Komuna e Dellçevës, e cila përmbush 78% të treguesve.

Mund të konkludohet se NJVL-të duhet t'i përpilojnë dhe t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre dokumentet strategjike dhe të planifikimit me afatin kohor për realizimin e tyre, alokimet buxhetore dhe organet përgjegjëse për zbatim.

### 3.3.2. Monitorimi dhe vlerësimi


Zbatimi i strategjive dhe i planeve vjetore të komunave duhet të analizohet përmes treguesve të dukshëm dhe lehtësisht të matshëm dhe duhet të prezantohet në mënyrë objektive mbi bazë të treguesve të përcaktuar paraprakisht. Mundësia për matje objektive të qëllimeve të realizuara e zvogëlon rrezikun që kanalet komunale për komunikim të jenë vetëm një „reklamë“ për punën e komunës.

Në këtë fushë treguesit bëjnë vlerësimin e shkallës deri në të cilën komunat e masin efektivitetin e politikave dhe aktiviteteve që i zbatojnë.

Hulumtimi tregoi se 73% ose 59 e NJVL-ve të monitoruara nuk përdorin tregues për suksesshmërinë gjatë përpilimit të planeve vjetore dhe reporteve të punës. Mosekzistimi i këtyre të dhënave i pamundëson publikut që në mënyrë reale të ndjekë punën e NJVL-ve dhe të ketë një pasqyrë të qartë për atë që është realizuar.

Sa i përket rajoneveplanifikuese, në nën-fushën e monitorimit dhe vlerësimit, rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Juglindor (16%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin Verilindor (0%).

*Grafiku 14. Përbushja e treguesve në nën-fushën e monitorimit dhe vlerësimit në rajonet planifikuese*



Në përgjithësi, NJVL-të duhet bëjnë vlerësim të rregullt të ndikimit, shpenzimeve dhe efekteve të politikave dhe këto të dhëna t'i përdorin për zhvillimin e planeve strategjike për të ardhmen. Grumbullimi i të dhënave për efektivitetin e politikave, shkallën e zbatimit të tyre dhe ndikimin e tyre do t'u mundësojë të gjenerojnë dhe publikojnë raporte të dobishme dhe reale në lidhje me progresin e realizimit të aktiviteteve.


### 3.4. QASSHMËRIA

„Qasshmëria“ i referohet mënyrës në të cilën NJVL-të komunikojnë dhe i përfshijnë qytetarët e komunës në përgjigjen ndaj kërkesave të tyre dhe në përmbushjen e nevojave të tyre.

Qasshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informacion, përmirësimin e qasshmërisë në informacion përmes mekanizmave për debate publike dhe përforcimin e ndërveprimit me pjesëmarrjen e qytetarëve. Komunitetet bëjnë këtë përmes mundësitë të qasjes në informacion dhe shërbimeve adekuate për qytetarët, konsultimit të qytetarëve dhe mundësitë të komunikimit dykahësh. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes ka një rëndësi të veçantë për demokracinë lokale, sepse çon në rritjen e transparencës.


Në fushën e qasshmërisë, hulumtimi tregoi se rezultati i vetëqeverisjes lokale është 22%, me rezultat më të lartë për treguesit për fushën e ndërveprimit me qytetarët prej 45%, dhe rezultatin më të dobët për fushat e tjera, qasja në informacion dhe shërbime prej 21% dhe konsultimet publike prej 18%.

Grafiku 15. Qasshmëria e NJVL-ve sipas tre nën-fushave



Sa i përket qasshmërisë, rezultate më të mira ka treguar komuna e Manastirit (51%), ndërsa më të dobëta komuna e Pllanicës (0%).

Grafiku 16.10 komunitat më të mira në fushën e qasshmërisë



Sipas rezultateve të fituara mund të konkludohet se NJVL-të duhet ta përmirësojnë procesin e konsultimeve publike dhe ta rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e krijimit të politikave dhe marrjes së vendimeve në nivel lokal përmes krijimit të më shumë mundësive dhe publikimit të më shumë informacioneve për përfshirjen e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve.

Në kuadër të kësaj fushe, treguesit janë të ndarë në tre nën-fusha:

- ▶ Qasja në informacione dhe shërbime, ku bën pjesë qasja e lirë në informacione me karakter publik, qasja në shërbime dhe informimi i qytetarëve për punën e komunës;
- ▶ Konsultimet publike, që i përfshijnë mundësitë e ndryshme për inkuadrim të qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve nga ana e Kryetarit dhe Këshillit të komunës, në punën e komunës dhe në planifikimin e buxhetit;
- ▶ Ndërveprimi me qytetarët, gjegjësisht mundësitë për komunikim të ndërsjellë mes komunave dhe qytetarëve përmes mjeteve qëllimore dhe mediave sociale, qasshmëria e Kryetarit dhe e organeve komunale.

### 3.4.1. Qasja në informacione dhe shërbime

Legjislacioni kombëtar dhe parimet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira tregojnë se qasja në informacione është një e drejtë themelore e qytetarëve të komunës. Komuna është e detyruar me ligj t'u ofrojë qytetarëve shumë shërbime. Qasja në shërbimet komunale, dhe mbi të gjitha në shërbimet elektronike, është shumë e rëndësishme për qytetarët dhe jetën e tyre të përditshme. Duke pasur parasysh pandeminë me COVID-19,

si dhe përcaktimin strategjik të BE-së për digjitalizim, zhvillimi i shërbimeve elektronike duhet të jetë një prioritet për vetë komunat. Si pjesë e kompetencave të tyre komunat kanë detyrim ligjor të krijojnë dhe të mbajnë regjistra në fusha të ndryshme. Publikimi i regjistrave, bazave të të dhënave dhe informacioneve nga fusha të ndryshme flet për një hapje të komunës për të kontribuar në zhvillimin e politikave sektoriale.


Rezultatet e hulumtimit tregojnë një përmbushje prej 21% të treguesve që kanë të bëjnë me nën-fushën e qasjes në informacione dhe shërbime nga ana e NJVL-ve. Kjo tregon se ende ekziston një zbatim jo i plotë dhe jokonsistent i Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, gjë që e kufizon transparencën e NJVL-ve dhe e pamundëson realizimin e plotë të së drejtës së personave fizikë dhe juridikë për qasje në informata me karakter publik.

Shumica e komunave nuk i publikojnë regjistrat, bazat e të dhënave dhe informacionet nga fushat e ndryshme që kanë detyrim ligjor për t'i krijuar dhe për t'i mbajtur. Në përgjithësi, NJVL-të nuk i publikojnë informacionet në ueb-faqet e tyre të cilat janë kërkuar përmes kërkesave të dorëzuara për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

Zhvillimi i shërbimeve elektronike në nivelin lokal ende nuk është në nivelin e kërkuar. Raporti „Cilësia e shërbimeve të ofruara nga NJVL-të përmes ueb-portaleve të tyre“ i Entit Shtetëror Statistikor, i publikuar në qershor të vitit 2021, tregon se „Cilësia aktuale e shërbimeve të cilat NJVL-të i ofrojnë përmes ueb portaleve të tyre nuk siguron një shërbim efektiv dhe të shpejtë. Nuk mundësohet trajtim i njëjtë, si dhe qasje dhe disponueshmëri e barabartë për secilin qytetar. Disponueshmëria e shërbimeve elektronike përmes internetit me zbatimin e Standardeve për ueb-qasje në shërbime elektronike nuk është ende në një nivel të kënaqshëm. Sigurimi i shërbimeve elektronike nuk është i unifikuar. Qasja në një shërbim të caktuar është e vështirë, si edhe kërkimi nëpër ueb-portale. Disponueshmëria e informacioneve, udhëzimeve, formularëve për shërbime të caktuara, si dhe kërkimi i përmbajtjeve në internet nuk është e njëtrajtshme për të gjitha NJVL-të. „Kjo situatë nuk mundëson zbatimin e shërbimeve në mënyrë efektive, me trajtim, qasje dhe disponueshmëri të barabartë për çdo qytetar.“

Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e qasjes në informacione dhe shërbime, rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Juglindor (29%), ndërsa rezultate më të dobëta ato në Rajonin Jugperëndimor (17%).

*Grafiku 17. Përbushja e treguesve në nën-fushën e qasjes në informacione dhe shërbime në rajonet planifikuese*



Sipas hulumtimit në nën-fushën e qasjes në informacione dhe shërbime, komuna e Ohrit dhe e Manastirit janë renditur më së larti me 53%, ndërsa komuna e Pllasnicës, Studeniçanit, Haraçinës dhe Mavrovës dhe Rostushës më poshtë me 0%.

Mund të konkludohet se NJVL-të duhet të punojnë më shumë për transparencën proaktive dhe të sigurojnë qasje më të madhe për qytetarët në informacione nga puna e tyre. Komunat duhet ta zbatojnë plotësisht Ligjin për Qasje të lirë në Informatat me Karakter Publik. NJVL-të duhet të zhvillojnë një numër më të madh të shërbimeve elektronike që ta përmirësojnë efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike dhe duhet t'i publikojnë dhe t'i përditësojnë rregullisht të gjitha informacionet dhe formularë që kanë të bëjnë me realizimin e shërbimeve.

### **3.4.2. Konsultimet publike**

Komuna është shkalla më e ulët e pushtetit dhe më këtë edhe më afër qytetarëve. Qasja në informacione dhe komunikimi i njëanshëm nuk mjaftojnë për të krijuar bashkëpunim me komunën. Nga komuna pritet që të ofrojë konsultime për qytetarët dhe të marrë mendim prej tyre për politikave publike, shërbimet, etj. Konsultimet publike kanë për qëllim krijimin e politikave të përgjegjshme të bazuara në dëshmi që i reflektojnë nevojat e qytetarëve.

Edhe pse përfshirja e vazhdueshme e qytetarëve në punën e komunave është e përcaktuar me ligjet dhe statutet dhe aktet komunale, rezultatet tregojnë një nivel të ulët të konsultimeve publike në nivel lokal.




Hulumtimi tregoi se në nën-fushën e konsultimeve publike NJVL-të kanë rezultat të ulët prej 18%. 33 komuna nuk kanë publikuar kurrëfarë të dhënash në këtë nën-fushë. Kjo tregon se NJVL-të urgjentisht duhet t'i dedikohen përmirësimit të konsultimeve publike dhe ato duhet të kryhen si online ashtu edhe offline.

Në përgjithësi, ueb-faqet e komunave përmbajnë informacion të pamjaftueshëm për konsultimet publike, në ueb-faqe nuk publikohen planet për konsultime publike, thirrjet për konsultime publike dhe raportet nga debatet publike të realizuara nga komuna.

Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e konsultimeve publike rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Juglindor (28%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin e Pollogut (4%).

*Grafiku 18. Përmbushja e treguesve në nën-fushën e konsultimeve publike në rajonet planifikuese*



Në nën-fushën e konsultimeve publike, rezultate më të mira ka treguar komuna e Gjorçe Petrovit, komuna Qendër dhe komuna e Radovishit me 69%, ndërsa 33 NJVL nuk kanë publikuar kurrëfarë të dhënash në këtë nën-fushë.

Pandemia e KOVID-19 vetëm e rriti nevojën për mbajtjen e konsultimeve publike online. Kështu, komunat duhet ta përcaktojnë detajisht procesin e konsultimit me hapa dhe afate kohore të përcaktuara saktësisht. Informacionet për konsultimet publike duhet të publikohen në kohë. Gjithashtu, komunat duhet ta inkurajojnë pjesëmarrjen në konsultime të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara.

### 3.4.3. Ndërveprimi me qytetarët


Për miratimin dhe zbatimin e suksesshëm të politikave publike lokale të cilat do të jenë të qëndrueshme dhe në shërbim të qytetarëve, në procesin e vendimmarrjes komuna duhet t'i inkuadrojë edhe qytetarët. Përveç një sërë mjetesh të parapara me ligj për konsultim me qytetarët dhe për inkuadrimitin e tyre në punën e komunës, ekzistojnë praktika shumë të mira të bashkëpunimit mes komunës dhe qytetarëve që kanë për qëllim njohjen dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe realizimin ad hok të sygjërimeve të tyre.

Në këtë nën-fushë janë përfshirë tregues që vlerësojnë nëse komunat përdorin mjete të ndryshme për ndërveprim me qytetarët, si mediat sociale dhe nëse aplikojnë mjete interaktive për komunikim në ueb-faqet e tyre. Në këtë mënyrë institucionet kanë për qëllim t'i përcjellin informacionet në një formë të përpunuar dhe t'i inkurajojnë qytetarët që të komunikojnë me to më shpesh. Nëpërmjet ndërveprimit me publikun mundësohet marrja e informacioneve kthyes nga qytetarët si përdorues final.

Hulumtimi tregoi se NJVL-të janë vlerësuar me 33% në nën-fushën e ndërveprimit me qytetarët. Numri më i madh i komunave kanë profile zyrtare në Facebook, ndësa disa prej tyre kanë profile edhe në media të tjera sociale. Një pjesë e madhe e komunave në Facebook e përdorin profilin e Kryetarit në vend të profilit zyrtar të komunës si vend primar për publikimin e informacioneve. Kjo paraqet një praktikë negative e cila duhet të çrrenjohet sepse në këtë mënyrë në fokus është reklamimi politik i vetë Kryetarit, e jo informimi në kohë dhe i saktë i qytetarëve në pajtim me nevojat e tyre. Vetëm 25 komuna në ueb-faqet e tyre kanë publikuar orar për konsultime të Kryetarit të komunës me qytetarët. Gjatë vitit të fundit vetëm 10 NJVL kanë vepruar sipas njërit propozimi të marrë përmes njërit nga mjetet për pjesëmarrje qytetare (iniciativës qytetare, tubimit të qytetarëve, referendumit, ankesës dhe propozimeve).

Sa i përket rajoneve planifikuese, në nën-fushën e ndërveprimit me qytetarët rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin Juglindor (40%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin Jugperëndimor (23%).

Grafiku 19. Përmbushja e treguesve në nën-fushën e ndërveprimit me qytetarët në rajonet planifikuese



Në nën-fushën e ndërveprimit me qytetarët, komuna e Vallandovës dhe Koçanit janë ranguar më lartë me 75%, ndërsa komuna e Pllasnicës dhe Bogdancit më dobët me 0%.

Është e domosdoshme që komunat t'u mundësojnë qytetarëve përdorim sa më efektiv të kanaleve të krijuara të komunikimit dhe t'i inkurajojnë ata t'i dërgojnë propozimet, nevojat dhe problemet e tyre përmes mjeteve për pjesëmarrje qytetare.

### 3.5. INTEGRITETI

*„Integriteti“ vlerëson respektimin konsekuent të vlerave, parimeve dhe normave etike që kanë për qëllim t'i japin përparësi interesit publik mbi atë privat*

Politikat për transparencë dhe hapje të komunave kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit. Integriteti i nëpunësve administrativë dhe zyrtarëve lokalë është baza për parandalimin e konflikteve të interesit dhe për funksionimin e drejtë të vetëqeverisjes lokale.


Sipas rekomandimeve të OBEZH-it, institucionet duhet të kenë zhvilluar një qasje strategjike për përmirësimin e integritetit publik dhe zbutjen e rrezikut nga korrupsioni në sektorin publik. Që kjo qasje të jetë efektive, masat duhet të bazohen në dëshmi të sigurt dhe të identifikojnë rreziqet në proces në konsultim me palët kryesore.

Kjo nën-fushë përmban tregues që tregojnë ekzistencën dhe qasshmërinë e politikës për integritet dhe antikorrupsion, edukim të nëpunësve administrativ për këtë temë, Kodit etik të nëpunësve administrativ dhe funksionerëve lokalë dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Rezultatet hulumtimit tregojnë se NJVL-të i kanë përmbushur vetëm 19% treguesit e fushës së integritetit. 21% e komunave nuk publikojnë kurrëfarë të dhëna në këtë fushë. Kjo tregon se komunat në strukturat e tyre duhet të vendosin mekanizma më të fuqishëm për përgjegjësi dhe të ndërmarrin më shumë aktivitete për promovimin e integritetit dhe parandalimin e konfliktit të interesit dhe korrupsionin. Vetëm 29 NJVL në ueb-faqen e tyre publikojnë informacione për sponsorizime dhe donacione, ndërsa vetëm 8 komuna publikojnë informacione të detajuara për shpalljet për punësim dhe për të sapopunësuarit me pikë në procedurën gjatë 12 muajve të fundit.


Në fushën e integritetit, rezultate më të mira kanë treguar komuna e Zhelinës, Demir Hisarit, Mogillës, Makedonska Kamenicës dhe Gjevgjelijë me 57%, ndërsa 22 NJVL nuk kanë publikuar kurrëfarë të dhënash në këtë fushë.

*Grafiku 20. 10 komunat me rezultate më të mira në fushën e integritetit*



Sa i përket rajoneve planifikuese, në fushën e integritetit rezultate më të mira kanë treguar NJVL-të në Rajonin e Pellagonisë (30%), ndërsa më të dobëta komunat në Rajonin e Pollogut (12%).

Grafiku 21. Përmbushja e treguesve në fushën e integritetit në rajonet planifikuese



Mund të konkludohet se komunat duhet të punojnë për vendosjen e sistemeve të integritetit dhe masave për parandalim dhe eliminim të formave të ndryshme të sjelljeve korruptive dhe joetike brenda institucionit. NJVL-të duhet t'i promovojnë kapacitetet e punonjësve në këtë fushë.

### 3.6. TË DHËNAT E HAPURA


Të dhënat e hapura janë në qendër të konceptit të Qeverisë së hapur ose Qeverisjes së hapur. Ato në mënyrë të drejtpërdrejtë kontribuojnë në rritjen e transparencës së NJVL-ve, përmirësimin e shërbimeve publike, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe për një efikasitet më të madh të punës së administratës. Në pajtim me Ligjin për Përdorimin e të Dhënave nga Sektori Publik, komunat janë të obliguara që vazhdimisht të publikojnë të dhëna të hapura.

Me këtë fushë horizontale indeksi „të dhënat e hapura“ i analizon praktikat e komunave për sa i përket shkallës së hapjes së të dhënave të cilat i publikojnë. Indeksi i shpërblen komunat të cilat angazhohen për publikimin e informacioneve në „format të hapur“ që është lehtësisht i përpunueshëm nga aspekti teknik.

Hulumtimi nxorri në pah se NJVL-të përmbushin vetëm 12% të treguesve të përfshirë në fushën e të dhënave të hapura. Edhe pse rezultatet në këtë fushë janë të dobëta, ka edhe disa shembuj të mirë të komunave të cilat punojnë për hapje të të dhënave.

Në fushën e të dhënave të hapura rezultate më të mira ka treguar komuna e Vasilevës dhe Ohrit me 27%, ndërsa më poshtë e ranguar është komuna e Pllasnicës me 0%.

Grafiku 22. 10 komunat në fushën e të dhënave të hapura



Rezultatet tregojnë se komunat publikojnë një pjesë të dokumenteve (grupe të të dhënave) që janë obligim i tyre ligjor, por jo të gjitha. Megjithatë, për herë të parë këtë vit, disa komuna kanë publikuar grupe të të dhënave në format plotësisht të hapur (të përpunueshëm nga makina).

Ohri, Kavadari, Prilepi, Vasileva, Zërnovci, Aerodromi, Shtipi, Gjorçe Petrovi, Vevçani, Zhelina, Kumanova dhe Rosomani për herë të parë këtë vit në ueb-faqet e tyre publikuan grupe të të dhënave në format të përpunueshëm nga makina. Edhe pse numri i komunave nuk është i madh (12) ky paraqet një përparim të rëndësishëm në punën e këtyre NJVL-ve dhe një hap të madh në angazhimet e tyre për promovimin e hapjes gjatë punës.

Është me rëndësi të përmendet se Qyteti i Shkupit publikoi 14 grupe të reja të të dhënave me format të hapur në portalin kombëtar data.gov.mk, por këto të dhëna nuk janë publikuar në ueb-faqen e tyre, e nuk ka as link që të dërgon deri tek të dhënat.

Portali kombëtar për të dhënat e hapura, data.gov.mk, deri më sot përmban 281 grupe të të dhënave të publikuara nga 57 subjekte, por vetëm 3 prej tyre janë nga NJVL-të.

Mund të konkludohet se edhe pse në disa komuna kemi një përmirësim në publikimin e të dhënave të hapura, përsëri, në përgjithësi, NJVL-të duhet të punojnë më shumë në përgatitjen e grupeve të të dhënave në format të hapur (të lexueshëm nga makina) dhe vazhdimisht t'i publikojnë dhe azhurnojnë ato.

---

### 3.7. KËSHILLAT KOMUNALË DHE NDËRMARRJET PUBLIKE

---

Edhe pse Këshilli komunal dhe ndërmarrjet publike janë pjesë përbërëse e NJVL-ve, ato, ndryshe nga sektorët, Kryetari i komunës, ose administrata me kontratë në vepër, kanë përgjegjësi dhe detyra të veçanta. Duke e pasur parasysh këtë, në Indeksin e hapjes si një kategori tjetër horizontale (përveç të dhënave të hapura) u monitoruan edhe treguesit për të cilët përgjegjësi të drejtpërdrejtë kanë Këshilli komunal dhe ndërmarrjet publike.

Në përgjithësi, suksesi, efikasiteti dhe transparencja në punën e Këshillit e ndjek edhe hapjen e komunës – që to të thotë se sa më transparent dhe efektiv të jetë Këshilli, aq më e hapur është komuna, dhe anasjelltas. Natyrisht që ka edhe komuna ku kjo lidhje nuk është aq lineare, por në të shumtën e rasteve, roli i Këshillit në hapjen e përgjithshme të komunës është në përputhje me sektorët e tjerë dhe administratën.

Sa i përket ndërmarrjeve publike, për fat të keq, për ato ne hasëm në një mungesë serioze të informacioneve në ueb-faqet e komunave. Tek një pjesë e komunave nuk ka kurrëfarë informacionesh, ose ka informacion minimal për përbërjen, punën dhe buxhetimin e ndërmarrjeve publike. Ndryshe nga Këshillat komunalë, niveli i hapjes në ndërmarrjet publike nuk është në hap me hapjen e komunës në të cilën vepron ajo ndërmarrje publike - domethënë ndërmarrjet publike kanë një transparencë mesatare dukshëm më të ulët prej vetëm 8%. Madje edhe tek komunat me një nivel relativisht solid të hapjes, ndërmarrjet publike mbeten „të mbyllura“, pra me 0% transparencë.

## 4. PËRFUNDIM

Hulumtimi i Indeksit të hapjes për vitin 2021 tregon se vazhdon niveli i ulët i përmbushjes së parimeve të qeverisjes së mirë nga NJVL-të.

Komunat duhet të rrisin transparencën në punën e tyre, dhe veçanërisht publikimin e të dhënave në lidhje me vendimet e marra nga Kryetari dhe Këshilli i komunës, dokumenteve strategjike dhe planifikuese, dokumenteve për monitorimin dhe matjen e efektivitetit të politikave dhe të dhënave në lidhje me operacionet financiare.

Kushtet e reja të jetesës të imponuara nga pandemia me KOVID-19 nxisin nevojën që autoritetet lokale të publikojnë më shumë të dhëna dhe të punojnë në mënyrë të vazhdueshme në krijimin e kanaleve të reja për dialog dhe bashkëpunim me qytetarët dhe palët e tjera. Kjo rrit përdorimin e TIK-ut për përmirësimin e hapjes në punën e komunave. Ueb-faqet e komunave duhet të zhvillohen në një nivel të lartë që të jenë një mjet funksional dhe i dobishëm për vizitorët. Ata duhet t'i përmbushin kërkesat për siguri kibernetike dhe të përshtaten me nevojat e përdoruesve.

Komunat duhet të punojnë më shumë për ta rritur hapjen dhe punën e tyre ta bazojnë në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes, të cilat, me ndihmën e teknologjive dhe inovacioneve të reja, do ta promovojnë qeverisjen publike dhe do ta përforcojnë administratën publike dhe demokracinë.

Zhvillimi i planeve strategjike të komunave duhet të bazohet në të dhënat nga vlerësimet e bëra për ndikimin, shpenzimet dhe efektet e politikave.

Ueb-faqet e komunave duhet të përmbajnë informacione dhe të dhëna më të hollësishme në lidhje me punën e ndërmarrjeve publike të themeluara nga komuna.

Sipas hulumtimit të bërë, mund të konkludohet se vazhdon të jetë problem zbatimi adekuat i kornizës ligjore në fushat e përfshira në hulumtim, para së gjithash Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter publik, Ligjit për Përdorimin e të Dhënave në Sektorin Publik dhe legjislacioni në lidhje me punën financiare të NJVL-ve.

NJVL-të në Rajonin planifikues të Pollogut dhe një pjesë e NJVL-ve në Rajonin planifikues të Shkupit duhet të bëjnë një angazhim më të madh për përmirësimin e hapjes në punën e tyre. Përpjekje të rëndësishme nevojiten nga NJVL-të në rajonin planifikues të Pollogut dhe një pjesë e NJVL-ve në rajonin planifikues të Shkupit për të përmirësuar hapjen në punën e tyre.



# 5. PLANI GJITHËPËRFSHIRËS PËR QEVERISJE TË MIRË PËR VETËQEVERISJEN LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Për të përmirësuar hapjen e komunave, në vazhdim janë prezantuar rekomandimet që duhet të shërbejnë si një plan gjithëpërfshirës për qeverisjen e mirë në nivel lokal.

## Transparenca

- ▶ Ueb-faqet e komunave të zhvillohen në përputhje me rekomandimet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, të jenë funksionale dhe të azhurnohen rregullisht. Kjo e përfshin edhe detyrimin për azhurnimin e rregullt të të gjitha versioneve gjuhësore të ueb-faqeve, pra informacionet të publikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të jenë të disponueshme në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës;
- ▶ Ueb-faqet e komunave t'i përmbushin kërkesat për siguri kibernetike;
- ▶ Komunitat të kenë përgatitur dhe publikuar një dokument që ka të bëjë me hapjen dhe transparencën e tyre dhe që do të ofrojë një qasje të definuar dhe sistematike në publikimin e informacioneve dhe të dhënave;
- ▶ Punonjësit në komunë në mënyrë të vazhdueshme t'i përforcojnë kapacitetet dhe njohuritë e tyre për obligimet ligjore dhe praktikën e mira në fushën e politikave të hapjes, duke përfshirë këtu edhe të dhënat e hapura;
- ▶ Të dhënat dhe informacionet e komunave nuk duhet të publikohen vetëm në gazetën zyrtare. Ato duhet të jenë të strukturuar mirë dhe të publikohen brenda menyve dhe rubrikave të ueb-faqeve ashtu që të mund të gjenden lehtë.
- ▶ Grupet e të dhënave që i gjenerojnë komunitat t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre, si dhe në portalin <http://data.gov.mk/> ;
- ▶ NJVL-të rregullisht dhe në kohë ta publikojnë rendin e ditës për seancat, si dhe procesverbalin dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me punën e Këshillit;
- ▶ Komunitat të publikojnë lista të plota të pozitave dhe kontakteve të të gjithë punonjësve me informacion për kontakt (emri dhe mbiemri, pozita, njësia/ sektori, numri i zyrës, telefoni zyrtar dhe e-maili)
- ▶ Komunitat të jenë transparente edhe për punësimet e përkohshme mbi baza të ndryshme dhe të publikojnë listë të personave të punësuar me kontrata (në vepër, autoriale, për punë të përkohshme përmes agjencive, etj.)

- ▶ Të bëhet një përmbledhje dhe të publikohen kompetencat e komunës me informacionet themelore për komunën në mënyrë që qytetarët të dinë se për çfarë lloj pyetjesh dhe shërbimesh duhet t'u drejtohen organeve komunale;
- ▶ Në ueb-faqen e komunës të publikohen informacionet për anëtarët e këshillit, organet e punës dhe bashkësitë urbane dhe lokale.
- ▶ Komunitat të publikojnë informacione më të detajuara për ndërmarrjet publike dhe institucionet e krijuara prej tyre;
- ▶ Vendimet e marra nga Kryetari i komunës dhe Këshilli të publikohen rregullisht në ueb-faqen e komunës;
- ▶ Komunitat të sigurojnë video (ose audio) monitorim të seancave të Këshillit dhe të publikojnë regjistrime audio/video si dokumente autentike që do të mundësojnë monitorim të punës dhe marrjes së vendimeve nga ana e Këshillit. Regjistrimet duhet të jenë në një format të përshtatshëm për shkarkim ose të mund të çojnë tek ndonjë platformë e jashtme për publikim (p.sh. kanali i komunës në YouTube)
- ▶ Komunitat në mënyrë proaktive të raportojnë për punën e Këshillit dhe të Kryetarit të komunës përmes publikimit në kohë të njoftimeve për mediat;
- ▶ Buxheti të publikohet bashkë me të gjitha dokumentet shoqëruese dhe informacionet e nevojshme për miratimin dhe realizimin e tij. Buxheti duhet të jetë i disponueshëm në tërësi, duke përfshirë këtu të ardhurat dhe shpenzimet e tij sipas zëreve, ashtu siç miratohet, së bashku me të gjitha rebalancet dhe dokumentet për realizimin e tij (planet financiare dhe raportet)
- ▶ Komunitat të publikojnë një buxhet programor të qytetarëve i cili është i prezantuar sipas fushave dhe në një mënyrë të kuptueshme;
- ▶ NJVL-të të publikojnë raporte tremujore për realizimin e buxhetit, llogarinë përfundimtare të komunës për vitin kalendarik paraprak, si dhe informacione për borxhet e komunës;
- ▶ NJVL-të t'i publikojnë të gjitha dokumentet për proceset e prokurimit publik në ueb-faqet e tyre (planet e prokurimit publik, thirrjet, vendimet, anekset, etj.)
- ▶ Në ueb-faqet e komunave të publikohen rrogat e zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar dhe informacione financiare për udhëtimet dhe përfaqësim të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe nëpunësve administrativ;
- ▶ NJVL-të të publikojnë informacione për procedurat për ankande publike, koncesionet ose PPP-të. Sigurimi i transparencës brenda këtyre procedurave është i domosdoshëm;
- ▶ NJVL-të të publikojnë të dhëna për mbështjetjen financiare që e japin për shoqatat e qytetarëve,

## Vetëdijësimi

- ▶ NJVL-të t'i publikojnë programet vjetore për punën e komunës dhe të Këshillit. Dokumentet duhet të mundësojnë vendosjen e qëllimeve të matshme përmes treguesve dhe udhëzimeve për matjen e tyre;
- ▶ Komunat t'i publikojnë Strategjitë për zhvillim të shoqëruara me plan veprimi për realizim (me buxhet të ndarë, kornizë kohore të definuar dhe me organet përgjegjëse – organe, sektorë, ndërmarrje ose institucione publike, etj);
- ▶ Komunat t'i publikojnë dokumentet planifikuese/programore të përpunuara për fusha tematike si zhvillimi ekonomik lokal, mjedisi jetësor, rinia, etj;
- ▶ Komunat t'i harmonizojnë dokumentet strategjike me buxhetet e komunave;
- ▶ Në ueb-faqet e NJVL-ve të publikohen raportet për punën e Kryetarit dhe Këshillit të komunës. Raportet duhet të përmbajnë tregues konkret për suksesin dhe matjen e efektivitetit të politikave të cilat i zbatojnë, shkallën e zbatimit dhe ndikimin e tyre.

## Qasshmëria

- ▶ Në ballinën e ueb-faqeve të komunave duhet të ketë një meny ose rubrikë të veçantë e të dukshme, ku do të ketë informacione për ushtrimin e së drejtës për qasje të lirë në të dhëna. Në këtë pjesë duhet të jetë e pëshkruar mënyra e kërkimit të informacionit, të jetë dhënë formulari që duhet të përdoret dhe një kopje elektronike e tij që mund të shkarkohet, të jetë caktuar një person përgjegjës për ndërmjetësimin e informacioneve dhe kontaktet e tij/saj, si dhe të jetë publikuar edhe lista e informacioneve me karakter publik e përcaktuar me ligj, etj;
- ▶ NJVL-të t'i publikojnë përgjigjet të cilat komuna tashmë ua ka dhënë qytetarëve mbi bazë të qasjes në informacionin me karakter publik. Këto informacione në ueb-faqe duhet të publikohen në mënyrë anonime, që t'u shërbejnë edhe qytetarëve të tjerë që do t'i kishin kërkuar të njëjtat informacione ose dokumente;
- ▶ Komunat të kenë një informator për qytetarët (të shtypur në letër ose elektronik) që në intervale të rregullta do t'ju sigurojë qytetarëve informacione (zakonisht mujore) në lidhje me aktivitetet e komunës dhe vendimet e rëndësishme të marra nga organet e komunës;
- ▶ Në ueb-faqen e komunave të publikohet një katalog i shërbimeve të cilat i ofron komuna fizikisht dhe në mënyrë elektronike. Për secilin shërbim, qoftë të ofruar fizikisht apo në mënyrë elektronike, duhet të publikohen edhe formularët, tarifat që duhen paguar për marrjen e akteve dhe mënyra e pagesës;

- ▶ NJVL-të në ueb-faqet e tyre t'i prezantojnë dokumentet që komuna duhet t'i sigurojë sipas detyrës zyrtare, që qytetarët të lirohen nga detyrimet e panevojshme dhe shkuarja në më shumë institucione, sipas sistemit me një pikë shërbimi;
- ▶ Komunitat në ueb-faqet e tyre të paktën një herë në vit t'i publikojnë raportet e inspektimit të kryer;
- ▶ NJVL-të t'i planifikojnë në kohë konsultimet publike për çështje të ndryshme të planifikuara sipas planeve dhe programeve vjetore të organeve komunale, t'i publikojnë thirrjet, planet dhe procesverbalet për konsultimet dhe seancat publike në ueb-faqet e tyre;
- ▶ Ueb-faqet e komunave të përmbajnë formularë elektronikë - mundësi për komunikim të dyanshëm, pjesë të veçantë për ankesat, parashtrirat dhe raportimin e problemeve;
- ▶ Në ueb-faqet e komunave të publikohet orar për qytetarët për konsultime me Kryetarin e komunës;
- ▶ Krahas kanaleve zyrtare, në mënyrë elektronike përmes ueb-faqes dhe fizikisht, NJVL-të t'i përdorin mediat sociale për komunikim të dyanshëm me qytetarët. Në këtë aspekt duhet të ketë një faqe zyrtare të komunës (jo profili i Kryetarit) në Facebook dhe në ndonjë medie tjetër sociale;
- ▶ NJVL-të ta rrisin numrin e shërbimeve të digjitalizuara të cilat ua ofrojnë qytetarëve;
- ▶ Komunitat tu mundësojnë qytetarëve marrjen në kohë të informacioneve adekuate, në një mënyrë të kuptueshme për ta, me çka do të mundësohet që qytetarët e interesuar të marrin pjesë në procese që janë me interes për komunitetin lokal dhe t'i shprehin nevojat dhe problemet e tyre.

### **Integriteti**

- ▶ NJVL-të të përpilojnë dhe të publikojnë dokument adekuat për parandalimin e konflikteve të interesit dhe praktikave korruptive;
- ▶ NJVL-të t'i përmirësojnë kapacitetet e punonjësve për parandalimin e sjelljeve joetike dhe korruptive, raportimin e parregullsive, etj;
- ▶ Komunitat në ueb-faqet e tyre të publikojnë Kodin e etikës për zyrtarët lokalë dhe nëpunësit administrativë, si dhe emrin dhe kontaktin e personit përgjegjës për raportimin e brendshëm të mbrojtur dhe personit përgjegjës për raportimin e parregullsive në operacionet financiare të komunës;
- ▶ Në ueb-faqen e NJVL-së për secilën procedurë për punësim të publikohet një thirrje me përshkrim të vendit të punës, kriteret dhe përshkrimin e procedurës

së përzgjedhjes dhe vlerësimit, si dhe një vendim për përzgjedhjen me emrin dhe mbiemrin e kandidatit, shpjegim dhe pikët e fituara për secilin kriter;

- ▶ Komunat rregullisht të publikojnë informacione për sponsorizimet dhe donacionet.

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis është një fondacion i pavarur, jopartiak dhe jofitimprurës me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Misioni i tij është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe të rrisë cilësinë e jetës përmes përdorimit inovativ dhe shkëmbimit të njohurive. Vlerat tona kryesore janë hapja, barazia dhe liria.

Fushat programore në të cilat punon Metamorfozis janë:

- ▶ Mediat për demokraci
- ▶ Edukimi për inovacione
- ▶ Përgjegjësia shoqërore
- ▶ Të drejtat e njeriut në internet

# SHTOJCA 1: STRUKTURA E INDEKSIT TË HAPJES NË NIVEL LOKAL

<b>Fusha: Transparenca</b>	
<b>Nën-fusha: Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie</b>	
1	A përditësohet rregullisht uebfaqja?
2	A publikohen informacionet në mënyrë të barabartë në të gjitha gjuhët zyrtare?
3	A është funksional mjeti për kërkim të ballina e ueb-faqes?
4	A ka komuna ndonjë dokument (strategji, politikë, procedurë) në lidhje me shkallën e hapjes dhe transparencën?
5	Gjatë vitit të fundit, a kanë ndjekur punonjësit e komunës ndonjë trajnim ose lloj tjetër të edukimit për qasje në informacione me karakter publik?
6	Gjatë vitit të fundit, a kanë marrë pjesë punonjësit e komunës në trajnim/punëtori për nëpunësit për konceptin e të dhënave të hapura dhe instruksione për mënyrën e përdorimit dhe publikimit të të dhënave në format të hapur?
7	A ka emëruar komuna Zyrtarë për të dhënat e hapura?
8	A publikon komuna grupe të të dhënave të hapura në data.gov.mk ?
<b>Nën-fusha: Informacionet organizative</b>	
9	A është publikuar në ueb-faqe organogrami i komunës?
10	A janë publikuar në ueb-faqe kompetencat e komunës?
11	A është publikuar në ueb-faqe biografia e Kryetarit të komunës?
12	A është publikuar në ueb-faqe Statuti i komunës?
13	A është publikuar në ueb-faqe Rregullorja e Këshillit të komunës?
14	A është publikuar në ueb-faqe informacion për emrat, pozitat dhe kontaktet e nëpunësve administrativë?
15	A është publikuar në ueb-faqe informacion për personat e angazhuar me kontrata në vepër, kontrata për punë të përkohëshme dhe kontrata autoriale?
16	A është publikuar në ueb-faqe informacion për anëtarët e Këshillit me emër, fotografi dhe kontakte?
17	A është publikuar lista e ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e komunës?
18	A është publikuar në ueb-faqe informacion për pjesëmarrjen e komunës në ndërmarrjet publike?
19	A janë të publikuara në ueb-faqe emrat dhe kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale/urbane?
20	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës informacione për komisionet dhe organet punuese të Këshillit?

21	A është publikuar statuti i ndërmarrjes komunale publike?
22	A janë publikuar informacione për anëtarët e këshillit drejtues dhe mbikëqyrës të ndërmarrjes publike komunale?

### **Nën-fusha: Vendimmarrja**

23	A janë publikuar në ueb-faqe agjendat për seancat e Këshillit?
24	A janë publikuar në ueb-faqe procesverbalet nga seancat e Këshillit?
25	A publikohen në ueb-faqe vendimet e miratuara nga ana e Këshillit?
26	A transmetohen drejtpërdrejt seancat e Këshillit nëpërmjet transmetimit audio ose video?
27	Gjatë vitit të fundit, a janë publikuar në ueb-faqe audio/video procesverbalet nga seancat e Këshillit?
28	Gjatë tre muajve të fundit a është publikuar në ueb-faqe të paktën një kumtesë/deklaratë për mediat nga Seancat e Këshillit?
29	A publikohen rregullisht në ueb-faqe njoftimet për takimet zyrtare të realizuara me informacion të detajuar nga takimi?

### **Nën-fusha: Transparenca financiare**

30	A është publikuar në ueb-faqe buxheti komunal për vitin aktual?
31	A ka publikuar komuna buxhet qytetar për vitin aktual?
32	A u dorëzua tek Këshilli vendimi për buxhetin para datës 1 dhjetor të vitit aktual?
33	A publikohen raporte tremujore për realizimin e buxhetit?
34	A është publikuar në ueb-faqe llogaria përfundimtare?
35	A publikohen informacione për borxhet e komunës?
36	A janë publikuar në ueb-faqe planet për prokurime publike?
37	A janë publikuar në ueb-faqe thirrjet për furnizime publike?
38	A janë publikuar në ueb-faqe vendimet për prokurimet publike?
39	A janë publikuar në ueb-faqe kontratat për prokurimet publike?
40	A janë publikuar në ueb-faqe anekset e kontratave për prokurimet publike?
41	A janë publikuar në ueb-faqe planet financiare vjetore dhe programet për realizimin e buxhetit?
42	A janë publikuar në ueb-faqe raportet e Entit Shtetëror të Revizionit?
43	A është publikuar në ueb-faqe informacioni për rrogat e funksionarëve?
44	Gjatë vitit të fundit, a është publikuar në ueb-faqe të paktën një informacion për koncesionet, PPP-të ose ankandet publike?
45	A janë publikuar në ueb-faqe raportet për realizimin e planit për prokurime publike?
46	Gjatë vitit të kaluar, a ka publikuar komuna të paktën një thirrje për projekte për organizatat qytetare?

47	A janë publikuar në ueb-faqe vendimet për fondet e ndara për organizatat qytetare?
48	A është publikuar llogaria vjetore e ndërmarrjes komunale publike?
49	A është publikuar akti me të cilin përcaktohen çmimet e shërbimeve të ndërmarrjes publike komunale?
50	A është publikuar akti për përdorimin e të ardhurave të realizuara nga ndërmarrja komunale publike?
51	A është publikuar llogaria përfundimtare e ndërmarrjes komunale publike?
52	A kanë qasje qytetarët në informacion për kompenzimet e anëtarëve të Këshillit të komunës?
53	A kanë qasje qytetarët në rregulloren për pagesën e shpenzimeve ditore për rrugë dhe për udhëtimet zyrtare në vend dhe jashtë tij për anëtarët e Këshillit dhe nëpunësit administrativë?

## Fusha: Vetëdijësimi

### Nën-fusha: Planifikimi dhe programimi

54	A është publikuar në ueb-faqe programi vjetor i komunës për vitin aktual?
55	A është publikuar në ueb-faqe programi vjetor i Këshillit të komunës për vitin aktual?
56	A janë publikuar në ueb-faqe strategjitë e sektorëve të komunës (që i referohen vitit aktual)?
57	A ka komuna dokument të shkruar gjithëpërfshirës ku i ka përcaktuar objektivat e saj (Strategji për zhvillim ose Plan për zhvillim) që i referohet edhe vitit aktual?
58	A ka publikuar komuna plan veprimi për realizimin e Strategjisë për zhvillim?
59	A është publikuar Programi vjetor për investime për vitin aktual i ndërmarrjes komunale publike?
60	A përdor ndërmarrja komunale publike tregues për sukses gjatë zhvillimit të programit vjetor?
61	A përdor komuna tregues për sukses gjatë zhvillimit të programit vjetor?

### Nën-fusha: Monitorimi dhe vlerësimi

62	A është publikuar në ueb-faqe raporti për punën e Kryetarit të komunës për vitin paraprak?
63	A është publikuar në ueb-faqe raporti për punën e Këshillit për vitin paraprak?
64	A është publikuar në ueb-faqe raporti për punën e ndërmarrjes komunale publike për vitin paraprak?
65	A përdor komuna tregues për sukses gjatë zhvillimit të raporteve vjetore për punën e vitit paraprak?



## Fusha: Qasshmëria

### Nën-fusha: Qasja në informacion dhe shërbime

66	A i publikon komuna propozim planet detajuara urbanistike për territorin e komunës?
67	A i publikon komuna planet e detajuara urbanistike të miratuara për territorin e komunës?
68	A ka publikuar komuna regjistër të organizatave qytetare?
69	A ka publikuar komuna listë të veprimtarive hotelierike me vëllim të vogël?
70	A ka publikuar komuna listë veprimtarive turistike me vëllim të vogël?
71	A ka publikuar komuna listë të shërbimeve për turizëm rural, etno turizëm dhe eko turizëm?
72	A ka publikuar komuna të dhëna për zonat industriale në territorin e komunës?
73	A ka publikuar komuna Kadastër të mjedisit jetësor?
74	A ka publikuar komuna Regjistër të Lejeve ekologjike B të integruara që i ka lëshuar?
75	A ka publikuar komuna Regjistër të ndotësve?
76	A ka publikuar komuna kadastër të gjeneruesve të zhurmës?
77	A ka publikuar komuna kadastër të gjeneruesve të mbeturinave?
78	A ka publikuar komuna të dhëna për transportuesit dhe automjetet për transportimin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor?
79	A ka publikuar komuna të dhëna për tregjet në territorin e komunës?
80	A ka publikuar komuna të dhëna për deponitë në territorin e komunës?
81	A ka publikuar komuna të dhëna për vendparkimet në territorin e komunës?
82	A ka publikuar komuna regjistër të çerdheve për fëmijë në komunë?
83	A ka publikuar komuna regjistër të shkollave fillore në komunë?
84	A publikon komuna regjistër të shkollave të mesme në komunë?
85	A ka publikuar komuna të dhëna për shtëpitë e pleqve në territorin e komunës?
86	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës raporte për mbikëqyrjet inspektorale të kryera?
87	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës informacione për institucione për mbrojtje të kategorive të ndryshme të qytetarëve?
88	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës informacione për numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale (sipas kategorive)?
89	A është publikuar në ueb-faqen e komunës Regjistër për mbeturinat (licencat e dhëna)?
90	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës qendrat për grumbullimin e mbeturinave elektronike dhe elektrike?

91	A janë publikuar licencat e dhëna për mënjanimin e automjeteve të dëmtuara dhe automjeteve me difekte nga rrugët komunale dhe lokale?
92	A është publikuar raporti vjetor për lejet e dhëna për ndërtim?
93	A është publikuar Regjistri për lejet e dhëna për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane?
94	A është publikuar Regjistri i kërkesave të parashtruara për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të paligjshme?
95	A është publikuar Regjistri i emrave të rrugëve dhe i numrave të objekteve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore?
96	A është publikuar Regjistëri i udhëheqësve të ndërtesave banesore?
97	A janë publikuar informacione për objektet sportive në territorin e komunës?
98	A janë publikuar informacione për klubet e sportit?
99	A është publikuar Regjistri i përmendoreve dhe pllakave përkujtimore?
100	A janë publikuar informacione për institucionet komunale nga fusha e kulturës?
101	A është publikuar Regjistri i personave fizikë që kryejnë veprimtari kulturore, guidave turistike dhe shoqëruesve turistikë?
102	A është publikuar Regjistri i objekteve të kategorizuara hotelerike?
103	A është publikuar evdidenca e hotelierëve?
104	A janë publikuar në ueb-faqe të dhëna për kontakt me personin përgjegjës për qasje në informatat me karakter publik?
105	A janë publikuar në mënyrë anonime përgjigjet e pyetjeve për të cilat është miratuar qasja në informatat me karakter publik?
106	A është publikuar procedura (mënyra) për marrjen e informatave me karakter publik?
107	A ka në ueb-faqe një meny (rubrikë) të veçantë me të drejtë për qasje në informatat me karakter publik?
108	A ka komuna gazetë mujore të vetën (ose informator)(elektronike ose të shtypur në letër)?
109	A janë publikuar në ueb-faqe përgjigjet e pyetjeve të parashtruara më shpesh?
110	A është publikuar në ueb-faqe Lista e informatave me karakter publik?
111	A mundëson ueb-faqja e-shërbime?
112	A është publikuar në ueb-faqen e komunës lista e shërbimeve të cilat i siguron komuna (fizike dhe elektronike)?
113	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës formularë për qasje në shërbime?
114	A është publikuar çmimorja për tarifatat për kompensimet për lëshimin e akteve?
115	A janë publikuar në ueb-faqen e komunës informacione për kushtet dhe kriteret për përdorimin e shërbimeve sociale dhe marrjen e ndihmës financiare?
116	A është publikuar emri dhe kontaktet e personit përgjegjës për kontakt me personat me invaliditet?

## Nën-fusha: Konsultimet publike

- 117 A është publikuar në ueb-faqe thirrja për pjesëmarrje në konsultim publik për buxhetin?
- 118 A është publikuar në ueb-faqen e komunës raport për konsultimin publik të mbajtur për propozim buxhetin e fundit?
- 119 A mundëson ueb-faqja qasje në planet për konsultimet publike të komunës për vitin aktual?
- 120 A janë publikuar në ueb-faqe thirrjet për seanca publike?
- 121 A ka në ueb-faqe informacione të nevojshme për seancat publike të vitit aktual?
- 122 A ka mbajtur komuna konsultime publike për propozim buxhetin e fundit?
- 123 A janë publikuar në ueb-faqe raportet e detajuara nga seancat publike? (me sqarime dhe përgjigje me shkrim të komenteve dhe sugjerimeve)
- 124 A organizon komuna forum të bashkësisë (ose forum buxhetor, si një formë e forumit të bashkësisë)?

## Nën-fusha: Ndërveprimi me qytetarët

- 125 A ekziston byro/zyrë për kontakt me qytetarët?
- 126 A ka caktuar Kryetari i komunës orar pranimi për konsultime me qytetarët?
- 127 A ka komuna profil aktiv në Facebook?
- 128 A ka komuna profil aktiv në ndonjë medie tjetër sociale?
- 129 A janë publikuar në ueb-faqe udhëzime për dërgimin e parashtrësive, ankeseve dhe kundërshtimeve?
- 130 A ekziston kanal i drejtpërdrejt online i komunikimit në ueb-faqe nëpërmjet të cilit qytetarët do të mund të dërgojnë parashtrësia, ankesa dhe kundërshtime?
- 131 A është publikuar orari i punës me palët?
- 132 A ka vepruar komuna në vitin e fundit në bazë të një propozimi të marrë nëpërmjet njërës nga mjetet për pjesëmarrje qytetare (iniciativë qytetare, tubim i qytetarëve, referendum, parashtrësë dhe propozime)?

## Fusha: Integriteti

### Nën-fusha: Politikat për integritet dhe konflikt të interesave

- 133 A është publikuar plan për integritet ose ndonjë procedurë tjetër e brendshme për antikorrupsion (që përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike në institucion)?
- 134 A është publikuar në ueb-faqe Kodi i Etikës për zyrtarët lokalë dhe nëpunësit administrativë?
- 135 A është publikuar në ueb-faqe emri dhe kontaktet e personit përgjegjës për raportimin e brendshëm të mbrojtur?
- 136 A është publikuar në ueb-faqe emri dhe kontaktet e personit përgjegjës për parregullsitë?

- 137 A publikon komuna në ueb-faqe informacione për sponsorizimet dhe donacionet?
- 138 A publikohen shpallje për punësim dhe personat e sapopunësuar me pikë në procedurën gjatë 12 muajve të fundit?
- 139 Gjatë vitit të fundit, a kanë ndjekur punonjësit e administratës komunale trajnim/punëtori ose aktivitete të tjera edukative në tema si konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit, raportimi i parregullsive?

